



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE  
PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 Date 02/12/2024

**“Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika “dh” citon “Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

**KËRKOJMË:**

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Dibër si më poshte:
  - 1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë 506 punonjës.
  - 1.2 Në institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër numri i punonjësve të jetë 83 punonjës.
  - 1.3 Funkcionet e deleguara (Arsimi Parashkollor 240 punonjës, Shërbimi Pyjor 10 punonjës, Ujitja dhe Kullimi 4 punonjës, MNZSH **31 punonjës**, Gjendja Civile në Njësit Administrative dhe Bashki 14 punonjës,) gjithsej 299 punonjës.
  - 1.4 Punonjës me kontratë pune të përkohshme mujore (6-8 muaj) për punë sezonale sipas nevojave të institucionit të jenë 10 punonjës .

3.Numri i punonjesve do te jete sipas tabelës së mëposhtme:

Punonjes te Administrates	506
Institucione ne Varesi	83
Funksione te Deleguara	299
Punonjes Sezonal me Kontrata 6-8 Muaj	10
<b>TOTALI:</b>	<b>898</b>

**PËR BASHKINË DIBËR:**

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala



Drejtori Ekonomik

Çeljeta Zuna



Drejtor i Drejtorise Juridike,

Ismet Saraçi



**KRYETARI I BASHKISË**

**Rahim SPAHJU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

RELACION

**Me të dhëna të grupuara, për numrin e punonjësve për projekt strukturën e Bashkisë Dibër, që mendohet të hartohet e miratohet për vitin kalendarik 2025**

**KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR**

Në zbatim të dispozitave të ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” pika “dh” Citohet: *“miraton buxhetin dhe Ndryshimet e tij. Ne vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu edhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë, si dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë.*

Referuar dhe praktikave të punës të ndjekura e përdorura në plotësimin e detyrave që ngarkon legjislacioni respektiv në vitet paraardhëse (2022,2023 dhe vitit 2024 që po mbyllim ), është menduar që numri i punonjësve gjithsej të Bashkisë Dibër edhe për vitin 2025 të jetë perafersisht I njejte me vitin 2024 me një ndryshim (numri maksimal i punonjësve të miratuar nga keshilli Bashkiak për vitin 2024 është 888 , ndërsa për vitin 2025 është menduar dhe propozuar që ky numër në të njëjtat kushte të jetë 898 me një diference prej 10 punonjës me shume të Drejtoria e MZSH bazuar ne fondin e ardhur shtese nga ministria)

Numri i punonjësve gjithsej të Bashkisë Dibër edhe për vitin 2025 të jetë si me poshte:

1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë **506 punonjës.**

1.2 Në institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër( Qendra Balneare, Qendra Kulturore, Klubi Futbollit “Korabi” dhe Klubi shumësportësh “Korabi”) numri i punonjësve të jetë **83 punonjës.**



1.3 Funksionet e deleguara (Arsimi Parashkollor 240 punonjës, Shërbimi Pyjor 10 punonjës, Ujitja dhe Kullimi 4 punonjës, **MZSH 31 punonjës**, Gjendja Civile në Njësiti Administrative dhe Bashki 14 punonjës,) gjithsej **299 punonjës**.

1.4 Punonjes me kontratë pune të përkohshme mujore (6- muaj) për punë sezonale sipas nevojave të institucionit të jenë **10 punonjës** .

Numri i punonjësve gjithsejt dhe sipas strukturave që jepen në pasqyrën përmbledhëse në këtë relacion, është paraprirë në këtë nivel duke i'u referuar përcaktimeve që jepen në ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konkretisht në :

Kreu VII Funksionet dhe kopetencat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore ,

Neni 21- Llojet e funksioneve,

Neni 22- Parimet për ushtrimin e funksioneve,

Neni 23-Funksionete Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Neni 24- Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale,

Neni 25- Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese,

Neni 26 - Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes mjedisit,

Neni 27 - Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë,zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, dhe natyrës së biodiversitetit ,

Neni 28 - Funksionet e bashkive në fushën e Zhvillimit ekonomik vendor,

Neni 29- Funksionet e bashkive në fushën e Sigurisë Publike

Neni 30- Funksionet dhe kopetencat e deleguara

Ky relacion që i bashkëlidhet Projekt vendimit “Për miratimin e numrit gjithsejt të punonjesve të bashkisë për vitin 2025 ”është përpiluar referuar përcaktimeve që bëhen në nenet që vijnë te ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,konkretisht:

Neni 54 - Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, pika “dh”

Neni 64 – Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë ,pika “j”

Në pasqyrën që vijon jepet numri i menduar për miratim i punonjësve për vitin 2025 sipas strukturave të vecanta të bashkisë , praktikë e cila do të jetë bazë për hartimin dhe miratimin e strukturës së bashkisë për vitin 2025 ne forme sintetike dhe analitike .

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i strukturave</b>	<b>Nëpunës /punonjës viti 2024</b>	<b>Projekt, Nëpunës /punonjës viti 2025</b>
	<b>Administrata e Bashkisë</b>		
1.	Kryetari i bashkisë	1	1
2.	Nënkryetarë të bashkisë	2	2
3.	Sekretari i Përgjithshëm	1	1
4.	Sekretari i këshillit bashkiak	1	1
	Punonjes i sekretariatit te Keshillit Bashkiak	1	1
5.	Drejtorja e Integritimit European	9	9
6.	Kabineti i Kryetarit	4	4
7.	Spektori i Auditit	4	4
8.	Spektori i IMTV	5	5
	Drejtorja e Mardhenieve me publikun dhe Median	10	12
	Drejtorja e Burimeve Njerezore	40	43
11.	Drejtorja e Kopshteve dhe Çerdheve	30	34
12.	Drejtorie Juridike Prokurimeve dhe Pronave	11	12
	Drejtorja e Rinise ,Sporteve dhe Higjenes	5	5
13.	Drejtorja ekonomike	20	23
	Drejtorja e Taksave	10	11
14.	Spektori i policisë bashkiake	13	13
15.	Drejtorja e Bujqësisë	11	11
16.	Drejtorja e PPECK	6	6
17.	Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit	8	8
18.	Drejtorja e Shërbimeve Publike	178	180
19.	Njësitë Administrative (me punonjes shërbimesh)	105	120
	<b>Institucione ne varësi</b>		
20.	Pallati i Kulturës	23	27
21.	Klubi Futbollit "Korabi"	7	7
	Klubi Shumësportësh "Korabi"	7	9
22.	Qendra Balneare "Enver Shehu"	37	40

	<i>Peshkopi</i>		
	<b><i>Funksiione te deleguara</i></b>		
23.	<i>Drejtoria e MZSH-s</i>	21	31
24.	<i>Zyrat e gjendjes civile (dhe Njësive Administrative)</i>	14	14
26.	<i>Sektori i Pyjeve dhe Kullotave</i>	10	10
27.	<i>Sektori i Administrimit të Ujërave</i>	4	4
28.	<i>Arsimi Parashkollor</i>	240	240
31.	<i>Punonjes sezonal</i>	50	10

Konkretisht në interpretim të tabelës ndryshimet e bëra do të jenë :

- Kabineti i Kryetarit nuk do të ketë ndryshime në numer punonjësish.
- Drejtorite dhe Sektorët të cilët nuk do të kenë ndryshime janë :
  - a) Drejtoria e Integrimit European
  - b) Sektori I Auditit
  - c) Sektori IMTV
  - d) Sektori I Policise Bashkiake
  - e) Drejtoria e Bujqesise
  - f) Drejtoria e PPECK
  - g) Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit
- Drejtoria e Mardhenieve me Publikun dhe Median e cila ka në varesi 2 sektore ka aktualisht **2 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të behen definitive.
  - a) Sektori I Teknologjise dhe Informacionit
  - b) Sektori i mardhenieve me publikun
- Drejtoria e Burimeve Njerezore e cila ka në varesi 3 sektore sektore ka aktualisht **3 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të behen definitive.
  - a) Sektori I Burimeve Njerezore
  - b) Sektori i Arsimit dhe Kultures
  - c) Sektori I Konviktit
- Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve e cila do të ketë në varësi Kopshtet e njesive Administrative dhe Sektorin e Cerdheve ka aktualisht **4 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të behen definitive.



- Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Pronave e cila do të ketë në varësi 3 Sektore ka aktualisht **1 punonjes** me kontrate I cili është parashikuar për vitin e 2025 të bëhet definitiv.
  - c) Sektori Juridik
  - d) Sektori i Prokurimeve
  - e) Sektori i Pronave
  
- Drejtoria Ekonomike ka aktualisht **3 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive.
  
- Drejtoria e Taksave e cila do të ketë në varësi 2 sektore ka aktualisht **1 punonjes** me kontrate I cili është parashikuar për vitin e 2025 të bëhet definitiv.
  - a) Sektori i Mbledhjes së të Ardhurave
  - b) Sektori i Kontrollit
  
- Drejtoria e Shërbimeve Publike e cila do të ketë 3 sektore në varësi ka aktualisht **2 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive.
  - a) Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve dhe Gjellbërimit
  - b) Sektori i Transportit dhe Ndricimit Publik
  - c) Sektori Mirmvajtjes së Objekteve dhe Rrugeve
  
- Njësitë Administrative kanë aktualisht **15 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive.
  
- **Institucionet në varësi:**
  
- Qendra Balneare “Enver Shehu” ka aktualisht **3 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive
- Qendra Kulturore Peshkopi ka aktualisht **4 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive
- Klubi i Futbollit “Korabi” nuk do të ketë ndryshime
- Klubi Shumësportësh “Korabi” ka aktualisht **2 punonjes** me kontrate të cilët janë parashikuar për vitin e 2025 të bëhen definitive
  
- **Funksionet e deleguara do të jenë më të shumta në numër kjo vjen si pasojë e shtimit të disa pozicioneve në Drejtorinë e MZSH-se**

- a) Drejtoria e MZSH-së nga 21 do te kete 31 punonjes.
- b) Sektori i Pyjeve dhe Kullotave do te jete I pandryshuar ne numer
- c) Sektori i Administrimit te Ujerve do te jete I pandryshuar ne numer
- d) Gjendja Civile do te jete e pandryshuar ne numer
- e) Arsimi Parashkollor do te jete e pandryshuar ne numer

➤ **Punonjës Sezonal do të jenë me një numër më të ulet nga 50 punonjes sezonal do te kete 10 punonjes sezonal per vitin 2025.**

Gjate vitit kalendarik 2024 ne strukturen e Bashkise kemi 50 punonjes me kontrate nga te cilet 40 punonjes te cilet jane ne mardhenie pune eshte parashikuar qe per vitin 2025 te behen definitiv. Eshte parashikuar qe 10 punonjes te jene me kontrate te perkohshme .

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për miratimin e Projekt vendimit “Për miratimin e numrit gjithsej të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrarive për vitin 2025”.

**Drejtore e Burimeve Njerëzore**

**Malbora LALA**